



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2018, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me anëtarin e AMA-s, zotin Zylyftar Bregu, në kuadër të shqyrtimit të kërkesës së kryetarit të AMA-s, për fillimin e procedurave për lirimin nga detyra si anëtar i AMA-s.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Fatmir Velaj, Bujar Çela dhe Besnik Baraj(zëvendësues).

Mungojnë:

Vilma Bello, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Zylyftar Bregu – anëtar i AMA-s.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëdita të gjithëve!

Zoti Bregu, faleminderit shumë që iu përgjigjët pozitivisht kërkesës sonë për të ardhur në dëgjuesë!

Ne, si Komision i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik kemi, gjithashtu, detyrën për të ndjekur nga afër veprimtarinë institucionale të dy institucioneve, që kanë vartësi nga parlamenti, AMA-s dhe RTSH-së.

Arsyeja se pse ju kemi thirrur është se, në shkresën nr.3403/1, të datës 01.11.2018, zoti Gentian Sala, kryetar i AMA-s, institucioni ku ju zhvilloni veprimtarinë tuaj në bord, i është drejtuar Kryetarit të Kuvendit, zotit Gramoz Ruçi, me kërkesën për lirim tuaj nga detyra dhe ka bërë një arsyetim për një kundërshtim në detyrimin kushtetues, që keni ju në përputhje me ushtrimin e mandatit, sipas ligjeve që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Arsyeja është zbulimi nga një media lokale, që quhet *cnn.al*, që ju keni një kontratë qiraje për një sipërfaqe toke, të lidhur në vitin 2015. Ndërkohë, përpara se komisioni të ndërmarrë çdo hap tjetër lidhur me këtë kërkesë, unë dua t'ju them se ne u vumë në dijeni, natyrisht nga detyra që ka Kuvendi i Shqipërisë, në zbatim të të gjitha funksioneve të veta kushtetuese dhe ligjvënës, që para se të bënim këtë dëgjuesë, të vihej në shërbim të komisionit jo vetëm kërkesa e zotit Sala, po gjithashtu të bëheshin edhe disa verifikime në lidhje me këtë kërkesë.

Ne, si komision, kemi marrë një dosje të plotë edhe nga Shërbimi i Monitorimit lidhur me vërtetësinë e kësaj kontrate, me një shkresë drejtuar Ministrisë së Bujqësisë, për të parë një status në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Gjithashtu, Shërbimi i Monitorimit na ka vënë në dispozicion edhe një deklaratë tuajën, firmosur në momentin që keni marrë detyrën si anëtar i Këshillit Drejtues të AMA-s.

Përpara se ne të fillojmë të bëjmë pyetje, do të kishim shumë nevojë të dëgjonim një shpjegim nga ana juaj.

Përpara se ju të merrni fjalën, ia japim fjalën sekretarit të komisionit, për të na thënë nëse kuorumi është i plotë.

Fidel Ylli – Kuorumi është i plotë dhe ne mund ta vazhdojmë seancën dëgjimore me zotin Bregu, por më vjen shumë keq që megjithëse kryetarja e komisionit, zonja Vokshi, dhe anëtarja e LSI-së, zonja Mehmetaj, e thyen bojkotin nëpërmjet dërgimit të një *e-mail-i*, për të na sugjeruar se si duhet të vazhdonte kjo seancë, nuk janë sot këtu në komision, që të shihnin

se ky nuk është komision hetimor, por është shumë transparent për të respektuar të gjitha të drejtat kushtetuese.

Ne mund të vazhdojmë normalisht.

Milva Ekonomi - Faleminderit!

Zoti Bregu, fjala është për ju.

Zylyftar Bregu – E nderuar kryetare,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për ftesën dhe mundësinë për të më dëgjuar!

Dje jam informuar pasdite, nëpërmjet postës elektronike, për këtë nismë. Ende në këto momente që po flasim nuk kam një dokument të shkruar, zyrtar nga Kuvendi.

Unë kam ardhur këtu në respekt tuajin, por do t'ju lutesha që të më lini kohë të arsyeshme që unë të përgatitem dhe të përgjigjem për atë që ju e quajtet "dosje".

Në respekt tuajin, paraprakisht, po ju them, meqenëse më vrau pak veshin fjala "është zbuluar", se ajo kontratë është e deklaruar në çdo deklaram zyrtar të pasurisë sime, që nga viti 2016.

Unë do t'ju lutesha të më lini kohën e arsyeshme, pasi të njoftohem zyrtarisht nga Kuvendi për t'iu përgjigjur të gjitha shqetësimeve dhe dyshimeve, që për mua nuk ekzistojnë, por gjithsesi jam transparent për t'iu përgjigjur çdo shqetësimi që ju keni.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zoti Bregu!

Unë mendoj se është e drejta juaj të merrni kohën e mjaftueshme, por edhe informimi që keni marrë nëpërmjet *e-mail-it*, quhet informim zyrtar, se aty keni bashkëngjitur të gjithë procedurën që ka zhvilluar Kuvendi deri më tani, para se të vinte shkresa, të depozitohej gjithë kjo dosje në komisionin tone. Megjithatë, është e drejta juaj të keni kohën e nevojshme për të përgatitur dëgjuesin përpara komisionit.

Zylyftar Bregu – Unë jam informuar vetëm dje, siç ju thashë, pasdite, diku nga ora 14 e pak minuta. Kjo është ora zyrtare e *e-mail-it*, por unë e kam hapur pak më vonë atë. Në verifikimin që i kam bërë *e-mail-it* rezulton kjo orë dhe në materialet e bashkëngjitura nuk është e vërtetë se është e gjithë procedura, se është vetëm kërkesa e zotit Sala.

Nuk ka dokument tjetër. Prandaj e theksoj edhe një herë se do të doja kohën e arsyeshme për t'iu përgjigjur çdo shqetësimi tuaj.

Milva Ekonomi – Dakord. Faleminderit!

Atëherë, ne do të marrim në konsideratë kërkesën tuaj dhe do të lëmë një kohë të përshtatshme që ju të njiheni me të gjitha dokumentet, që janë prezente në këtë kërkesë dhe në verifikimet që janë bërë.

Zylyftar Bregu - Faleminderit!

Milva Ekonomi - Faleminderit!

Konfirmimin për takimin e ardhshëm do ta merrni nëpërmjet e-mail-it dhe mesazheve që sekretaria e komisionit zakonisht u dërgon të gjithë personave që ftohen në këtë komision, në takime apo në dëgjesa. Sekretaria dërgon një *e-mail*; gjithashtu bën edhe një konfirmim në një mesazh në celularin e çdo individi që ftohet në komision.

MBYLLET MBLEDHJA